

Njoftim për përqendrim me të cilin ALTA GROUP SHPK Beograd, Serbi do të fitojë kontroll mbi STOPANSKA BANKA A.D. Manastir, Maqedonia e Veriut (lënda nr. 08-89/2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 25.05.2025, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës i është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin ALTA GROUP SHPK Beograd, me seli në adresën Ugrinovačka 212, lokali nr. 1, Zemun-Beograd, Serbi, do të fitojë kontroll mbi STOPANSKA BANKA A.D. Manastir me seli në adresën Dobrivoje Radosavleviq nr.21, Manastir, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

ALTA GROUP SHPK Beograd me veprimtari kryesore ndërmjetësim tjetër monetar. ALTA GROUP SHPK Beograd dhe shoqëritë e lidhura me të nuk janë të pranishme në Maqedoninë e Veriut dhe nuk kanë realizuar të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

STOPANSKA BANKA A.D. Manastir është një nga bankat rajonale komerciale në tregun e Maqedonisë me një histori të gjatë të aktivitetit afarist dhe prani të fortë në fushën e shërbimeve financiare, duke përfshirë mbledhjen e depozitave, dhënien e kredive, pagesat, bankat elektronike dhe aktivitete të tjera bankare shoqëruese. STOPANSKA BANKA A.D. MANASTIR ka personat e mëposhtëm të lidhur të cilët janë të regjistruar në Maqedoninë e Veriut:

1. ODA EKONOMIKE AMERIKANE NË MAQEDONINË E VERIUT Bashkësi e Interesit Ekonomik, me NUAS 5470315, me seli të subjektit në Maksim Gorki nr.11, Shkup dhe me veprimtari prioritare – veprimtari të organizatave të tjera mbi bazë anëtarësimi,;
2. Shoqata për realizimin e interesave të përbashkëta të bankave dhe përmirësimin e punës së tyre SHOQATA BANKARE MAQEDONASE Shkup me NUAS 7277156, me seli të subjektit në Orce Nikolov nr.75, Shkup dhe me veprimtari prioritare – veprimtari të organizatave të tjera mbi bazë anëtarësimi;
3. Shoqëri për tregtie dhe shërbimes PELAGONIA FINANCE SHPK Shkup – në likuidim, me NUAS 6914187 me seli të subjektit në Maqedonia nr.38, Shkup dhe me veprimtari prioritare veprimtari menaxhuese.

Për nevojat e vlerësimit të përqendrimit në fjalë, parashtruesi i njoftimit propozon që tregu relevant i produkteve të definohet si treg i ofrimit të shërbimeve bankare, ndërsa tregu relevant gjeografik të definohet si territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të

dërgohen në adresën: rr. “Shën Kirili dhe Metodi” nr.54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi.

30.05.2025

Shkup